



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E  
MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 5522/Prot.

Tiranë, më 29.7.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1793, datë 18.03.2016.

**SHOQËRISË “ALLBENIA-FERRO” SH.P.K**

**Rr. “Sheshi Italia”, Tirana Sheraton Hotel & Towers , Kati 1 Shopping Mall, Tiranë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË**  
**MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë**

Shoqëria “ALLBENIA-FERRO” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1793, datë 18.03.2016, për mineralin kuarc, në Objektin “Kërrnajë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3600 prot., datë 28.06.2026, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 5522 Prot., datë 01.07.2026, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit datë 18.03.2016, për mineralin kuarc, në Objektin “Kërrnajë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi subjekti nuk ka realizuar pagesën e garancisë financiare për vitin 2026. Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1793, datë 18.03.2016, për mineralin kuarc, në Objektin “Kërrnajë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1793, datë 18.03.2016, për mineralin kuarc, në Objektin “Kërrnajë”, Bashkia

Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**ENEA KARAKAÇI**  
**ME URDHËR PËR DELEGIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ERLIND SULO**

